



**Republika e Kosovës - Republic of Kosova**  
**Komuna – Municipality**  
**Hani i Elezit**



**05/ Nr. 05/113/ 2018**

Në bazë të Rregullores për kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve me Nr. 01/ 11159/ 2016 të datës 22.12.2016 dhe Vendimin për ndarjen e mjeteve financiar për bursa për student dhe caktimin e prioriteteve për quadro deficitare në Kuvendin e Komunës Nr.01/515/2018 të datës 25.01.2018, Drejtoria Komunale për Arsim, Kulturë Rini dhe Sport shpall:

**KONKURS PËR NDARJEN E BURSAVE PËR STUDENTËT NË KOMUNËN HANI I ELEZIT**  
**Kushtet për aplikim:**

**Të drejtë për të aplikuar për bursë kanë të gjithë studentët të cilët plotësojnë këto kushte;**

- a) të jenë banorë rezidentë të Komunës së Hanit të Elezit,
- b) të jenë student të rregullt, por jo me vet financim,
- c) të kenë regjistruar vitin,
- d) studentin nëse një herë ka përsëritur vitin, **humbë të drejtën e bursës (vlen për gjitha vitet),**
- e) të jenë student i Universitetit Publik të Kosovës,
- f) studentin i cili ka qenë përfutues i bursës në një fakultet, nuk mund të jetë përfutues i bursës për fakultetin e dytë,
- g) studentin nëse e ka një fakultet të përfunduar, nuk ka të drejt aplikimi për bursë,

**Dokumentet e nevojshme për konkurim:**

- a) certifikata e provimeve (**me vulë origjinale**),
- b) vërtetimi i semestrit (**me vulë origjinale**),
- c) fotokopje ID apo indeksin (fotografin, semestrat dhe notat),
- d) deklaratat e bashkësisë familjare,
- e) certifikatën e vendbanimit,
- f) dëshmia se është; invalid i luftës, fëmijë i dëshmorit, veteranit të luftës, martirit të luftës, person me aftësi të kufizuara, familja në skemën sociale, nuk i ka dy prindër, dy dhe një prindër të hendikepuar, i të burgosurit politikë, me gjendje të rënd ekonomike, nuk e ka njërin prind, dëshmi (vërtetim) për punë vullnetare, për të gjitha këto të cekura më lartë duhet të sjellin dëshminë nga shoqatat dhe institucionet përkatëse (**me vulë origjinale**),
- g) diplomat, mirënjohjet, çertifikatat për suksesin e arritur në gara-konkurse kombëtare dhe ndërkombëtare në lëmin e arsimit,
- h) Studentët e vitit të parë u merret nota mesatare e suksesit të shkollës së mesme të lartë dhe numri i pikëve të testit të arritshmërisë dhe provimet e dhëna në fakultetin përkatës,
- i) kopjen e letërnjoftimit dhe
- j) vërtetim mbi llogarinë bankare (origjinale)

**Sqarim shtesë:** Për bursë kanë **prioritet studentet e vitit të dytë e më lartë**, në rast se nuk plotësohet numri i studentëve që plotësojnë kriteret sipas rregullores do të plotësohet me studentët e vitit të parë sipas **Nenit 15 pika 15.1.9.**

**Vërejtje:** Nëse në dosjen e aplikuesit mungon një dokument apo nuk përputhen të dhënat e kërkuara sipas kriterëve të konkursit, aplikacioni nuk do të shqyrtohet nga ana e komisionit.

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve bëhet në **Qendrën për Shërbim të Qytetarëve të komunës.**

Afati për aplikim është **15 ditë** kalendarike nga dita e publikimit (**fillon-01/02/2018, mbaron 15/02/2018**).

Hani i Elezit  
Data: 01.02.2018

**Drejtori i DKA-s**  
**Menduh Vlasi**